



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br.	209/20
Nr. i fq. / Br. st	- 13 -
Data: / Datum	29. 10. 2020
VUSHTRRI VUČITRN	



**REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI**

---

**RREGULLORE  
(KKV) NR.08/2020 PËR DHËNIEN E DEKORATAVE**

Vushtrri tetor 2020,

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 shkronja “c” dhe nenin 40, paragrafi 2 “h” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L- 040, si dhe nenit 41, paragrafi 2 shkronja “c” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **29 tetor 2020** miraton këtë:

## **RREGULLORE PËR DHËNIEN E DEKORATAVE**

### **KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është themelimi i bazës juridike dhe përcaktimi i llojit të dekoratës, i dhënies dhe revokimit eventual të saj nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, për qytetarët e Republikës së Kosovës, personat juridik, qytetarët e huaj dhe organizatat e ndryshme që shquhen për merita të veçanta ndaj Komunës së Vushtrrisë dhe interesave të saj.

#### **Neni 2 Fushëveprimi**

1. Kjo rregullore përcakton procedurat dhe kriteret për dhënien dhe revokimin eventual të dekoratave nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, si dhe të drejtat dhe detyrat e të dekoruarve.
2. Të gjitha dekoratat në emër të komunës i aprovon Kuvendi i Komunës, ndërsa i jep kryetari i komunës.
3. Organet tjera të komunës, po ashtu mund të japid mirënjojje apo falënderime nën titullin e tyre, të nënshkruara nga drejtori i institucionit që jep mirënjojje apo falënderime dhe të vulosura me vulën e institucionit përkatës.
4. Organet e cekura si në paragrafin 3 të këtij neni, janë të obliguara të mbajnë evidencë, protokoll ose regjistër të veçantë me të gjitha shënimet për lëshimin e tyre.

**Neni 3**  
**Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

- 1.1. **Dekoratë nënkuption** – titulli ”Qytetar nderi”, titulli ”Nderi i qytetit”, çmimi ”Emblema e Vushtrrisë”, çmimi ”Hasan Prishtina”, çmimi ”Krenaria e Sportit të Vushtrrisë”, çmimi ”Lutfi Musiqi”, çmimi ”Rrustem Hyseni”, çmimi ”Poeteshat shqiptare”, çmimi ”Pena e artë”, çmimi ”Nxënës i dalluar”, çmimi ”Sofra jonë”, medalje ”Sportist i viti”, mirënjohje dhe falënderime;
  
- 1.1. **Revokim i dekoratës nënkuption** - heqja e së drejtës për bartjen e dekoratës së dhënë.

**KREU II**  
**DEKORATAT**

**Neni 4**  
**Llojet e dekoratave**

1. Lloje të dekoratave sipas kësaj rregulloreje janë:

- 1.2. titulli ”Qytetar nderi”,
- 1.3. titulli ”Nderi i qytetit”,
- 1.4. çmimi ”Emblema e Vushtrrisë”,
- 1.5. çmimi ”Hasan Prishtina”,
- 1.6. çmimi ”Krenaria e Sportit të Vushtrrisë”
- 1.7. çmimi ”Lutfi Musiqi”,
- 1.8. çmimi ”Rrustem Hyseni”,
- 1.9. çmimi ”Poeteshat shqiptare”,
- 1.10. çmimi ”Pena e artë”,
- 1.11. çmimi ”Nxënës i dalluar”,

- 1.12. çmimi “Sofra jonë”,
- 1.13. medalje ”Sportist i vitit”, dhe
- 1.14. mirënlohje dhe falënderime.

**Neni 5**  
**Titulli ”Qytetar nderi”**

1. Titulli ”Qytetar nderi” është titulli më i lartë që i jepet një personaliteti apo një grupi personalitetesh të shquara politike, shoqërore, shkencore, letrare dhe artistike (vendor e ndërkombëtar), në shenjë respekti, miqësie apo mirënlohjeje për kontributet e veçanta në fusha të ndryshme në të mirë të qytetarëve të Vushtrrisë.
2. Titulli ”Qytetar nderi” u jepet edhe personaliteteve të ndryshme, të cilat në kohë të vështira ndihmuani dhe kontribuan për lirinë e Kosovës;
3. Ky titull nuk iu ndahet qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë;
4. Titulli përbëhet nga një çelës, i cili simbolizon çelësin e ”portës” së komunës, si dhe një fletëpërcjellje;
5. Çelësi ka gjatësi 30 cm, ngjyrë ari, në të cilin shkruhet emri dhe mbiemri i personit që i jepet titulli, i shkruar me shkronja të graviuara në pjesën e dorezës dhe teksti: ”Qytetar nderi”;
6. Fletëpërcjellja është një letër e cilësisë së lartë e formatit A4, me ngjyrë ari, në sfondin e së cilës shihet stema e Komunës së Vushtrrisë;
7. Në pjesën e sipërme të fletës shkruan: Komuna e Vushtrrisë shpall ”Qytetar nderi” z/znj. (emri dhe mbiemri, vendbanimi, komuna, shteti), dhe
8. Titullin ”Qytetar nderi” e jep kryetari i komunës në mbledhje solemne të Kuvendit të Komunës.

## **Neni 6**

### **Titulli “Nderi i qytetit”**

1. Titulli ”Nderi i qytetit” është dekorata që iu ndahet personalitetevë të shquara të Komunës së Vushtrrisë, të cilët kanë dhënë kontribut të dalluara, që kanë lartësuar emrin e qytetit dhe kanë një veprimitari të gjërë e të rëndësishme në dobi të qytetarëve, vlera të veçanta e të njoitura edhe në rrafshin kombëtar dhe që janë personalitetë të rëndësishme në fusha të shoqërisë, shkencës, artit dhe sportit;
2. Ky titull iu ndahet qytetarëve që kryejnë akte të larta humanizmi, heroizmi dhe sakrifice;
3. Medalja ka formë të rrumbullakët, është e punuar në bronz e praruar në ngjyrë ari, me diametër 7 cm, në mesin e së cilës gjendet stema e Komunës së Vushtrrisë dhe mbishkrimi Komuna e Vushtrrisë, ndërkaq nën të shkruhet emri dhe mbiemri i të dekoruarit;
4. Fletëpërcjellja përbëhet nga një fletë e kualitetit të lartë të formatit A4 dhe në sfondin e fletës shihet stema e Komunës së Vushtrrisë, kurse në pjesën e sipërme të saj shkruhet: ”Nderi i qytetit”;
5. Kryesuesi i kuvendit të komunës e lexon vendimin e kuvendit mbi shpalljen ”Nderi i qytetit” dhe e thërret kryetarin e komunës për dhënien e titullit;
6. Titullin ”Nderi i qytetit” e jep kryetari i komunës në mbledhje solemne të Kuvendit të Komunës, sipas procedurave të parapara me këtë rregullore;
7. Ky titull i ndahet vetëm një personi brenda vitit kalendarik, dhe
8. Titulli përbëhet nga medalja dhe fletëpërcjellja, si dhe nga shuma në vlerë prej 1000 Euro.

## **Neni 7**

### **Çmimi “Emblema e Vushtrrisë”**

1. Çmimi ”Emblema e Vushtrrisë” iu jepet personalitetevë të shquara të komunës së Vushtrrisë, të cilët kanë dhënë kontribut të veçantë në rrafshin kombëtar, që janë personalitetë të rëndësishme në fusha të veçanta, kanë një veprimitari të gjërë dhe të

rëndësishme në interes të qytetarëve, si dhe tregojnë akte të larta të guximit dhe sakrificës;

3. Pllakëza ka formë të rrumbullakët, e punuar në bronz, e praruar në ngjyrë ari, në mesin e si cilës gjendet llogoja e komunës dhe mbishkrimi Komuna e Vushtrrisë, ndërsa nën llogu shkruhet: Emri dhe mbiemri i të dekoruarit;
3. Fletëpërcjellja është një letër e cilësisë së lartë e formatit A4, me ngjyrë ari, në sfondin e së cilës shihet stema e Komunës së Vushtrrisë, dhe
4. Ky çmim përbëhet nga një pllakëz dhe fletë përcjellëse, si dhe nga shuma financiare në vlerë prej 700 Euro.

### **Neni 8** **Çmimi “Hasan Prishtina”**

1. Çmimi ”Hasan Prishtina” iu ndahet personaliteteve të shquara në shenjë nderi dhe respekti për kontributin e dhënë në fushën kombëtare, shkencore, kulturore, artistike dhe letrare;
2. Ky çmim ndahet vetëm në manifestimet tradicionale ”Ditët e Hasan Prishtinës”;
3. Medalja ka formë rrathi, është i punuar në bronz, i praruar në ngjyrë ari, me diametër 10 cm, në mesin e të cilës gjendet portreti i Hasan Prishtinës dhe mbishkrimi Komuna e Vushtrrisë, ndërkaq nën të shkruhet emri dhe mbiemri i të dekoruarit me titull ”Ditët e Hasan Prishtinës”, vendbanimi, komuna dhe shteti;
4. Fletëpërcjellja shkruhet në letër të cilësisë së lartë, të formatit A4, me ngjyrë ari, në sfondin e së cilës shihet stema e Komunës së Vushtrrisë;
5. Në pjesën e sipërme të fletëpërcjelljes shkruan: Komuna e Vushtrrisë ndan çmimin ”Hasan Prishtina”;
6. Çmimin ”Hasan Prishtina”, e ndan kryetari i komunës në mënyrë solemne;
7. Çmimi përbëhet nga medalja me portretin e Hasan Prishtinës dhe një fletëpërcjellje, si dhe nga shuma financiare në vlerë prej 500 Euro.

**Neni 9**  
**Çmimi “Krenaria e Sportit të Vushtrrisë”**

1. Çmimi “Krenaria e Sportit të Vushtrrisë” iu ndahet sportistëve individual (një sportisti) dhe sportit kolektiv (një klub sportiv) për arritje kulminante në sport në gara me karakter nacional apo ndërkombëtar.
2. Çmimin “Krenaria e Sportit të Vushtrrisë” e ndan kryetari i komunës në mënyrë solemne;
3. Për arritje në sportin individual, sportistikët/së bashku me dekoratën, i ndahet edhe shpërblimi në shumë prej dymijë euro (2,000.00 €) ndërsa për sportin kolektiv–klubit i ndahet shpërblim në shumë prej pesëmijë euro (5,000.00 €).
4. Medalja ka formë të rrumbullakët, është e punuar në bronz e praruar në ngjyrë ari, me diametër 7 cm, në mesin e së cilës gjendet stema e Komunës së Vushtrrisë dhe mbishkrimi Komuna e Vushtrrisë, si dhe Mbishkrimi “Krenaria e Sportit të Vushtrrisë” ndërkaq nën të shkruhet emri dhe mbiemri i të dekoruarit;
5. Fletëpërcjellja përbëhet nga një fletë e kualitetit të lartë të formatit A4 dhe në sfondin e fletës shihet stema e Komunës së Vushtrrisë, kurse në pjesën e sipërme të saj shkruhet: “**Krenaria e Sportit të Vushtrrisë**”;

**Neni 10**  
**Çmimi “Lutfi Musiqi”**

1. Çmimi ”Lutfi Musiqi” iu ndahet studentëve dhe hulumtuesve të shkencave teknike, që janë banorë të Vushtrrisë apo kanë kontribuar për Komunën e Vushtrrisë dhe ndahet vetëm një brenda vitit kalendorik;
3. Çmimi shoqërohet me një fletëpërcjellje të cilësisë së lartë, formati A4, në sfondin e së cilës shihet stema e Komunës së Vushtrrisë, në të cilën shkruan: Për sukseset në fushën e shkencave teknike, Komuna e Vushtrrisë ndanë çmimin “Lutfi Musiqi” z-znj. (emri dhe mbiemri), ndërkaq në fund të fletës në anën e djathtë shkruhet emri, mbiemri, nënshkrimi i kryetarit të komunës dhe në mes të fletës vendoset vula e komunës;
4. Çmimin e ndanë kryetari i komunës në mënyrë solemne, dhe
5. Ky çmimi shoqërohet edhe me shumën financiare në vlerë prej 500 Euro.

**Neni 11**  
**Çmimi “Rrustem Hyseni”**

1. Çmimi ”Rrustem Hyseni” iu jepet studentëve dhe hulumtuesve të shkencave shoqërore, që janë banorë të Vushtrrisë dhe kanë kontribuuar për Komunën e Vushtrrisë.

2. Ky titull i ndahet vetëm një personi brenda vitit kalendarik.;

3. Çmimi shoqërohet me një fletëpërcjellje të cilësisë së lartë, formati A4, në sfondin e së cilës shihet stema e Komunës së Vushtrrisë dhe në të cilën shkruan: për suksese të veçanta në fushën e shkencave shoqërore, Komuna e Vushtrrisë jep çmimin ”Rrustem Hyseni” z-znj.(emri dhe mbiemri), ndërkaq në fund të fletës në anën e djathjtë shkruhet emri, mbiemri, nënshkrimi i kryetarit të komunës, kurse në mes të fletës vendoset vula e komunës;

4. Çmimin e jep kryetari i komunës në mënyrë solemne, dhe

5. Ky çmimi shoqërohet edhe me shumën financiare në vlerë prej 500 Euro.

**Neni 12**  
**Çmimi “Poeteshat shqiptare”**

1. Çmimi ”Poeteshat shqiptare” iu ndahet jepet tri poeteshave të cilat janë shpallur nga juria fituese të 3 vendeve të para sipas kësaj radhitje:

1.1. Vendi i parë 500 €;

1.2. Vendi i dytë 300 €;

1.3. Vendi i tretë 200 €.

2. Çmimi ”Debutuesja” t’i ndahet poeteshës e cila merr pjesë për të parën herë dhe është më e reja në moshë. Çmimi shoqërohet me ”Fletëpërcjellje” dhe vlerën prej njëqind 100 €;

3. Çmimi shoqërohet me një fletëpërcjellje;

4. Fletëpërcjellja shkruhet në letër të cilësisë së lartë, formati A 4, me ngjyrë ari, të sfondin e së cilës shihet stema e Komunës së Vushtrrisë;

5. Në pjesën e sipërme të fletëpërcjelljes shkruan: Komuna e Vushtrrisë ndan çmimin “Poeteshat shqiptare” znj.(emri dhe mbiemri i fitueses së shpërblimit, vendbanimi, komuna, shteti);
6. Në fletëpërcjellje shkruhet edhe numri i protokollit, kurse në fund të fletës në anën e djathtë shkruhet emri, mbiemri, nënshkrimi i kryetarit të komunës dhe në mes të fletës vendoset vula e komunës;
7. Çmimin e ndan kryetari i komunës në mënyrë solemne,

**Neni 13**  
**Çmimi “Sofra jonë”**

1. Çmimi “Sofra jonë” iu ndahet bujqve, blegtoreve, pemëtarëve, bletarëve, kopshtarëve dhe të gjithë prodhuesve të tjerë të Komunës së Vushtrrisë, në shenjë mirënjojje dhe respekti për kontributin e tyre në zhvillimin e ekonomisë së komunës;
2. Fletëpërcjellja shkruhet në letër të cilësisë së lartë, formati A 4, me ngjyrë ari, në sfondin e së cilës shihet stema e Komunës së Vushtrrisë;
3. Në pjesën e sipërme të fletëpërcjelljes shkruan: Komuna e Vushtrrisë ndan çmimin “Sofra jonë” z-znj.(emri dhe mbiemri i fituesit të shpërblimit, vendbanimi, komuna, shteti), për suksese të arritura në prodhimin e \_\_\_\_\_;
4. Në fletëpërcjellje shkruhet edhe numri i protokollit, ndërkaq në fund të fletës në anën e djathtë shkruhet emri, mbiemri, nënshkrimi i kryetarit të komunës dhe në mes të fletës vendoset vula e komunës;
5. Çmimin e ndanë kryetari i komunës në mënyrë solemne, dhe
6. Ky çmim i ndahet vetëm një personi brenda vitit kalendarik, dhe i jepet me rastin e “Ditës së Patates”;
7. Ky titull i ndahet vetëm një personi brenda vitit kalendarik, dhe
8. Çmimi shoqërohet me një fletëpërcjellje dhe me shumën financiare në vlerë prej 300 Euro.

**Neni 14**  
**Çmimi “Pena e artë”**

1. Çmimi “Pena e artë” iu ndahet artistëve dhe personaliteteve të shquara nga fusha e shkencës, arsimit, artit, dhe kulturës për aktivitete të dalluara në nivel kombëtar e ndërkontinentar, që kanë një personalitet të pastër qytetarie dhe që gëzojnë popullaritet;
2. Çmimi përbëhet nga medalja dhe një fletëpërcjellje;
3. Medalja ka formë të rrumbullakët, është e punuar në bronz, e praruar me ngjyrë ari, me diametër 10 cm, në mesin e së cilës gjendet “simboli i penës” dhe mbishkrimi Komuna e Vushtrrisë, kurse në qendër të saj me ngjyrë ari shkruan ”Pena e artë”, ndërkaq në fund emri, mbiemri dhe viti i të dekoruarit;
4. Çmimi “Pena e artë” shoqërohet me një fletëpërcjellje të cilësisë së lartë, formati A4, në sfondin e së cilës shihet stema e Komunës së Vushtrrisë, ku shkruan: për merita të veçanta (fusha e kontributit), Komuna e Vushtrrisë ndanë titullin ”Pena e artë” zaznj.(emri dhe mbiemri), ndërkaq në fund të fletës në anën e djathtë shkruhet emri, mbiemri, nënshkrimi i kryetarit të komunës dhe në mes të fletës vebndoset vula e komunës, dhe
5. Ky titull i ndahet vetëm një personi brenda vitit kalendarik.
6. Çmimi shoqërohet me një fletëpërcjellje dhe me shumën financiare në vlerë prej 300 Euro.

**Neni 15**  
**Medalja “Sportisti i vitit”**

1. Kjo medalje ndahet me rastin e shpalljes së Sportistit të Vitit, për sportistëve të dalluar.
2. Në rastet sipas paragrafi 1 të këtij neni, ndahen këto medalje:
  - 2.1. Sportisti i Vitit (për të rritur), në vlerë financiare prej 600 Euro;
  - 2.2. Sportistja e Vitit (për të rritur), në vlerë financiare prej 600 Euro;
  - 2.3. Sportisti i Vitit (për të rinjë), në vlerë financiare prej 500 Euro, dhe
  - 2.4. Sportistja e Vitit (për të rinjëtë), në vlerë financiare prej 500 Euro.

3.Medalja ka diametër 5 cm, në pjesën e lartë nën rreth shkruhet: Komuna e Vushtrrisë, më poshtë me ngjyrë ari: “Sportisti i vitit” dhe në pjesën e fundit viti i marrjes së medaljes;

4.Medalja shoqërohet me një fletëpërcjellje të cilësisë së lartë, formati A4, në sfondin e së cilës shihet stema e Komunës së Vushtrrisë dhe në të cilën shkruan: për suksese të veçanta në... (lloji i sportit), Komuna e Vushtrrisë ndanë medaljen “Sportisti i vitit” z.-z. (emri dhe mbiemri), ndërsa në fund të fletës në anën e djathtë shkruhet emri, mbiemri, nënshkrimi i kryetarit të komunës dhe në mes të fletës jepet vula e komunës, dhe

### **Neni 16** **Mirënjohjet dhe falënderimet**

1.Mirënjohjet dhe falënderimet iu ndahen atyre personaliteteve, të cilat kanë dhënë një kontribut të dalluar, në fusha të ndryshme në të mirë të qytetarëve;

2. Mirënjohja dhe falënderimi përbëhen nga një fletë e kualitetit të lartë, me formatin A4, në sfondin e fletës shihet stema e Komunës së Vushtrrisë, kurse në pjesën e sipërme të saj shkruhet: Komuna e Vushtrrisë ndanë mirënjohje apo falënderim z.-z. (emri dhe mbiemri i fituesit të shpërbimit, vendbanimi, komuna, shteti), kurse në to shkruhet numri i protokollit, ndërkaq në fund të fletës në anën e djathtë emri, mbiemri, nënshkrimi i kryetarit të komunës dhe në mes të fletës vendoset vula e komunës;

3. Mirënjohjet dhe falënderimet i jep kryetari i komunës në mënyrë solemne,

4. Me rastin e Ditës së Çlirimt, nuk mund të ndahen më shumë se dhjetë (10) mirënjohje dhe falënderime.

### **Neni 17** **Dhënia e dekoratave**

1. Dekoratat iu ndahen personave fizik dhe juridik, konform kontributeve, vlerave dhe ndikimin e tyre në opinionin publik;

2. Dekoratat mund t'iu ndahen qytetarëve të Republikës së Kosovës, personaliteteve të njohura publike, personave juridik dhe subjekteve tjera;

3. Dekoratat mund t'iu ndahen qytetarëve edhe pas vdekjes;

4. Dekoratat mund t’iu ndahen shtetasve të huaj, personalitetave të njoitura botërore dhe organizatave ndërkombëtare;
5. Të njëjtë person nuk mund t’i ndahet dy herë e njëjtë dekoratë, si dhe personi që ka marrë dekoratë, i njëjtë nuk mund të marrë më vonë mirënjojje apo falënderim;
6. Në rastet kur në ditën e dorëzimit të dekoratës nuk është prezent personi që i dedikohet dekorata apo, dekorata ruhet në Sekretarinë e Kuvendit deri në 30 ditë. Brenda këtij afati mund të tërhiqet dekorata edhe nga i afërm i tij, dhe
7. Nëse brenda këtij afati nuk tërhiqet dekorata, ajo i dorëzohet me procesverbal arkivit të komunës.

### **Neni 18 Propozimet për dekorata**

1. Propozimin për ndarjen e titullit ”Qytetar nderi”, ”Nderi i qytetit” dhe ”Emblema e Vushtrrisë”, mund ta bëjnë: Kryetari i Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa, së paku 1/3 e anëtarëve të Kuvendit të komunës, apo iniciativa qytetarë me mbi 700 nënshkrime të qytetarë të Komunës së Vushtrrisë;
2. Propozimin për çmimin ”Hasan Prishtina”, mund ta bëjnë: Kryetari i komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa, secili nga anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë;
3. ”Lutfi Musiqi”, ”Rrustem Hyseni” dhe ”Pena e Artë”, mund ta bëjnë: Kryetari i komunës, secili nga anëtarët e kuvendit, institucionet e arsimit si dhe Komiteti Konsultativ për Arsim;
4. Propozimin për çmimin ”Sofra Jonë” mund ta bëjnë; Kryetari i komunës, secili nga anëtarët e kuvendit, si dhe Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike;
5. Propozimin për çmimin ”Nxënës i Dalluar”, e bënë: Drejtoria e Arsimit;
6. Të gjitha dekoratat e përmendura në nenin 4 të kësaj rregulloreje, mund të ndahen edhe për rastet ”Post Mortum”, (pas vdekjes);
7. Propozimet për dekorata duhet të paraqiten te Komisioni për Shqyrtimin e Propozimeve të tyre me shkrim së paku 15 ditë para datës në të cilën merret vendimi për ndarje të dekoratës;

8.Përjashtimisht nga paragrafi 7 i këtij nenit, në rrethana të arsyeshme që vlerësohet nga komisioni për dekorata se nuk ka qenë e mundur të paraqitet propozimi për dekorata. Ky afat mund të jetë edhe më i shkurtë, por jo më pak se 72 orë nga dita kur merret vendimi lidhur me to.

### **Neni 19 Shqyrtimi i propozimeve**

1. Kryetari i komunës në çdo fillim viti kalendarik e formon komisionin për shqyrtimin e propozimeve dhe iniciativave për dekorata me mandat njëvjeçar me këtë përbërje: 3 nga ekzekutivi dhe 2 nga OJQ-të, ndërsa Komisionin për përzgjedhjen e sportistit të vitit formohet nga Kryetari i komunës, pas shqyrtimit të propozimeve të klubeve sportive;
- 2.Të gjitha propozimet për dekorata i adresohen për shqyrtim të mëtutjeshëm komisionit në fjalë për dekorata;
- 3.Komisioni në fjalë i propozon listën e ngushtë Kuvendit të Komunës për miratim;
- 4.Kuvendi i Komunës merr vendim për ndarje të dekoratave me propozim të komisionit në fjalë;
- 5.Çdo propozim duhet të jetë i arsyetur me shkrim para komisionit në fjalë, ndërsa kryetari i komisionit të gjitha propozimet i arsyeton para anëtarëve të kuvendit;
- 6.Të gjitha dekoratat të cilat i ndan Kuvendi, i nënshkruan kryetari i komunës, ndërsa vendimin për dekorata e nënshkruan kryesuesi i kuvendit.

### **KREU III DISPOZITAT E PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 20 Shfuqizimi i Rregulloreve paraprake**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen: Rregullorja 01Nr. 186/13, dt.25.07.2013 Për dhënien e dekoratave dhe Rregullorja 01Nr. 88/15, dt.30.04.2015 Për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për dhënien e dekoratave.

### **Neni 21 Revokimi i dekoratave**

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë rezervon të drejtën e revokimit të dekoratave, në raste të veçanta kur fituesit e tyre dënohen për vepra të rënda penale.

**Neni 22**  
**Përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregulloreje**

Për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohet: kryetari i Komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**Neni 23**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit lokal dhe shtatë (7) ditë publikimit në faqen zyrtare të komunës.

